



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 647/23

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Argjira Asllani, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatorë e panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari G. S., për shkak të dy veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 8 muaj dhe dënim unik me gjobë në shumë prej 6000€, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, KP.nr.916/22, i datës 16.01.2023, i ndryshuar me aktvendimi e Gjykatës Supreme të Kosovës Pzd.nr.98/2023, të datës 14.08.2023, ashtu që të dënuarin e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 2 muaj, ndërsa ka mbetur i pandryshuar vendimi mbi dënimin me gjobë. pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117 dhe 118 par. 4 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 12, 13, 14, 18, 22, 25 par.1 pika 1.2 dhe nenin 33 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me 07.12.2023, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për lirimin me kusht e të dënuarit G. S. nga i ati S. dhe e ëma R., e gjinisë M., i lindur me datë ..., me vendbanim në rr. "...", ..., ..., nr. ..., P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. Kërkesa për lirimin me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 6 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, KP.nr.916/22, i datës 16.01.2023, G. S. është shpall fajtor për shkak të dy veprave blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e

narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 8 muaj dhe dënim unik me gjobë në shumë prej 6000€. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Pzd.nr.98/2023, të datës 14.08.2023, duke vendosur mbi kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit ka ndryshuar aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që të dënuarin e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 2 muaj, ndërsa ka mbetur i pandryshuar vendimi mbi dënimin me gjobë.

I dënuari e ka parashtruar kërkesën për lirim me kusht përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg. Kërkesa për lirim me kusht është parashtruar me datën 30.10.2023, me të cilën është kërkuar që të lirohet me kusht, me arsyetimin se gjatë vuajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Paneli për lirim me kusht në seancën e mbajtur me datën 07.12.2023 pasi e shqyrtoi kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se:

Kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar.

Nga shkresat e çështjes, dosja e të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirimin normal e ka me datën 07.03.2025 dhe nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rezulton se gjer më tani i ka vuajtur 1 vit, 11 muaj, ndërsa i kanë mbetur edhe 1 vit, 3 muaj. Paneli gjatë shqyrtimit të dosjes i ka vlerësuar edhe raportet e tjerë të përpiluara nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, në të cilat është konstatuar se i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit ka dy raporte për shkelje disiplinore, me datë 13.12.2022 dhe 28.12.2022 dhe se sjelljet e tij brenda institucionit nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese janë cilësuar arrogante. Po ashtu, në raportet për të dënuarin është konstatuar se i njëjti nuk është bashkëpunues, tani ka ndryshuar qëndrim ndaj veprës penale, ku e pranon veprën penale vetëm për lirim me kusht dhe se është konstatuar se mbetet i lartë rreziku për recidivizëm.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, Paneli ka vlerësuar kushtet për lirim me kusht, të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, duke përfshirë kriteret e parashikuara në Rregulloren 01/39 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për lirim me kusht. Kriteret përfshijnë: peshën e krimit, historinë e kaluar kriminale, përshkrimin e personit të dënuar për krimin, qëndrimin ndaj viktimës, sjelljen gjatë burgimit, gjendjen psikiatrike dhe psikologjike, gjendjen fizike, historinë sociale, planet pas lirimit, pranimin e kontrollit dhe ndihmën nga Shërbimi Sprovues, ekzistencën e një rreziku të përgjithshëm për publikun, dhe perspektivën e një personi të dënuar me origjinë të huaj për të kthyer në shtëpi.

Paneli, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerësimit të gjitha kushteve dhe kriterëve si më lartë, me rastin e vendosjes për kërkesën e të dënuarit konstatoi se nga të dhënat mbi shkeljet disiplinore, i dënuari ka rënë ndesh me rregullat e Institucionit Korrektues, me ç'rast nuk është plotësuar kriteri i nenit 14, pika 1.5 e Rregullores Nr. 01/39, “Sjelljen e mirë gjatë burgimit”, për lirim me kusht, prandaj mbi bazën e kësaj ka ardhur në përfundim se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej 6 muaj dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Nga sa u tha më lartë, në zbatim të nenit 25 pika 1.2 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT
PLK. D. nr. 647/23, datë 07.12.2023

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 117 par. 16 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është e lejuar ankesa.